



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
DHOMAT E SHKALLËS SË DYTË
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

K.DH.SH.II.nr.100/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së dytë, me gjyqtarin individual Ramush Bardiqi, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Premium Bau, Sh.P.K., me seli në Prishtinë, rr. “Raif Pallomi”, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit A.Sh., avokate nga Prishtina, kundër debitorit Alko-Impex-General Construction Sh.P.K., me seli në Prishtinë, rr. “Ndue Përlleshi”, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit Shoqëria e Avokatëve SCRL Partners Sh.P.K., me seli në Prishtinë, lidhur me çështjen përmbarimore për borxh, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.1992/22 të datës 31.10.2023, me datë 11.03.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e bazuar ankesa e kreditorit Premium Bau, Sh.P.K., me seli në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.1992/22 të datës 31.10.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykatës Komerciale, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.1992/22 të datës 31.10.2023, e ka aprovuar si të bazuar prapësimin e debitorit Alko-Impex-General Construction Sh.P.K, duke e ka anuluar urdhrin përmbarimor P.nr.809/21 datë 22.12.2021 të lejuar nga Zyra Përmbarimore e Përmbaruesit Privat Irfan I. Kërçaku me seli në Prishtinë, dhe e ka përfunduar në tërësi procedura përmbarimore.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori Premium Bau, Sh.P.K., për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, zbatimit të gabuar të dispozitave materiale dhe zbatimit të gabuar të dispozitave të procedurës përmbarimore, me propozimin që aktvendimi i atakuar të ndryshohet apo të anulohet dhe lënda të kthehet në rivendosje.

Përgjigje në ankesë nuk ka parashtruar debitori.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale – Dhomat e shkallës së dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3 par.2 të Ligjit

nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore (LPP), si dhe në kuptim të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), gjeti se:

- **Ankesa e kreditorit është e pabazuar.**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Premium Bau, Sh.P.K., me seli në Prishtinë, me datën 22.12.2021 ka paraqitur propozim për lejimin e përmbartimit, kundër debitorit Alko-Impex-General Construction Sh.P.K., në bazë të dokumentit të besueshëm – Faturës Nr.05/019 të datës 29.11.2019 në shumën e borxhit prej 103,685.18 €, me bartjen e mjeteve në llogarinë e kreditorit.

Zyra Përmbartimore e Përmbartuesit privat Irfan I. Kërçaku me seli në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, ka lëshuar urdhrin përmbartimor P.nr.809/21 datë 22.12.2021, me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm – Faturës Nr.05/019 të datës 29.11.2019 në shumën e borxhit prej 103,685.18 €, me të cilin ka kërkuar që të obligohet debitori që në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit t'i paguaj kreditorit borxhin me kamatë prej 8% si dhe shpenzimet e përmbartimit sipas tarifës së përmbartuesve privat.

Gjykata Themelore në Prishtinë, duke vendosur lidhur me prapësim e debitorit dhe përgjigjen në prapësim të kreditorit, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar KPPP.nr.1992/22 të datës 31.10.2023, e ka aprovuar si të bazuar prapësimin e debitorit Alko-Impex-General Construction Sh.P.K, duke e ka anuluar urdhrin përmbartimor P.nr.809/21 datë 22.12.2021 të lejuar nga Zyra Përmbartimore e Përmbartuesit Privat Irfan I. Kërçaku me seli në Prishtinë, dhe e ka përfunduar në tërësi procedura përmbartimore.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka theksuar se në rend të parë me nenin 29 të LPP-së, para. 1 nënpara. 3 ka rregulluar se *"Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm. Dokument i besueshëm, sipas këtij ligji është (...) 1.3 fatura ndërsa në para. 3 ka parapare se "Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar"*. Nga këto dispozita rrjedhë se, përmbartimi mund të fillohet edhe në bazë të faturës si dokument i besueshëm dhe se për ta caktuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm, ai duhet ta ketë përmbajtjen e kërkuar ligjore. Në rastin konkret, fatura lëndore i përmban të gjitha elementet e kërkuara me nenin e cituar më lartë, gjegjësisht kërkesa për përcaktimin e kohës së përmbushjes së detyrimit monetar e ka plotësuar përmes deklaratës për kërkuarshërin. Megjithatë, fatura lëndore nuk e përmban as nënshkrimin e as vulën e Debitorit, që nënkupton se ajo nuk është pranuar nga debitori. Gjithashtu, në shkresa të lëndës nuk ka prova se Debitori e ka konfirmuar përmes e-mailit pranimin e faturës lëndore. Gjykata gjithashtu rikujton se nuk ka asnjë provë nga e cila do të provohej se Debitori në ndonjë mënyrë e ka pranuar faturën lëndore. Si rezultat i mungesë së pranimit kësaj fature, vjen deri të mungesa e tipareve të përmbartueshmërisë së dokumenteve të besueshëm. Për pasoj duhet të zbatohet neni 71 para. 1 nënpara. 1.1 të LPP-së, sipas të cilit *"(.) prapësimi mund të bazohen vetëm nëse dokumenti, në baze të cilit është marr vendimi përmbartues ose urdhri përmbartues, nuk ka titull ekzekutiv ose nuk ka tipare të përmbartueshmërisë"*. Për gjykatën, mungesa e lartëcekur në dokumentin e besueshëm

paraqet pengesë të pakapërcyeshme ligjore, rrjedhimisht nuk mund të lejohet përmbartimi, prandaj e anuloi Urdhrin. Meqenëse nuk kishte çështje tjetër për tu trajtuar, gjykata e përfundoi procedurën si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi..

Vlerësimin dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Dytë, e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë, në bazë të nenit 194 të LPK-së, i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbartimore me rastin e vendosjes për aprovim të prapësimit të debitorit. Fillimisht propozimin për përmbartim është ushtruar në bazë të faturës e cila sipas propozimit ka numrin 05/19 të datës 29.11.2019, e cila nuk i përmban tiparet e një fature të rregullt dhe nuk i plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm në procedurë përmbartimore. Neni 29 par.3 i LPP, i cili përcakton se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbartjes së detyrimit monetar”*.

Mbi bazën e kësaj dispozite ligjore, kjo Gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka konstatuar drejtë se fatura si dokument i besueshëm mbi të cilën ishte iniciuar procedura përmbartimore, respektivisht është lejuar përmbartimi nuk i plotëson kushtet në mënyrë kumulative që duhet t'i ketë dokumenti i besueshëm. Në rastin konkret qartë rezulton se fatura nuk e përmbanë as nënshkrimin dhe as vulvën e debitorit si elemente esenciale për të qenë dokument i përmbartueshëm. Rrjedhimisht, në rast të mungesës së ndonjërit nga këto elemente dokumenti konsiderohet i papërshtatshëm për përmbartim.

Gjykata Komerciale - Dhomat e shkallës së dytë duke shqyrtuar pretendimet ankimore të kreditorit, të njëjtat i vlerëson si të pabazuara dhe të pa qëndrueshme, kjo për faktin se gjykata e shkallës së parë drejtë ka konstatuar se prapësimi nuk është i bazuar dhe nuk përmban asnjë nga shkaqet e përcaktuara me nenin 71 të LPP-së, ngase fatura në bazë të së cilës është lëshuar Urdhri Përmbartimor, nuk mund të trajtohet si dokument i besueshëm në kuptim të nenit 29 të LPP-së, si dhe përmban të gjitha të gjitha elementet e kërkuara nga dispozita e lartcekur.

Andaj, duke marr parasysh pretendimet ankimore, të cilat konsistojnë ndaj aktvendimit të ankimit, Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhomat e Shkallës së Dytë konsideron se këto pretendimet ankimore janë të pa bazuara, ngase nuk kemi të bëjmë me shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore, dhe zbatimin të gabuar të drejtës materiale, të cilat shkelje kjo gjykatë i vështron sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, dhe as të Ligjit të Procedurës Përmbartimore.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 209 pika b) të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhoma e shkallës së dytë

Kom.Dh.Shk.II.nr.100/24 dt.11.03.2024

**Gjyqtari,
Ramush Bardiqi**